



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 203

Tiranë – E mërkurë, 29 dhjetor 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 810, datë 24.12.2021	Për një shtesë në vendimin nr. 717, datë 23.6.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore”, të ndryshuar..... 20525
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 811, datë 24.12.2021	Për lirim nga detyra..... 20525
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 812, datë 24.12.2021	Për emërim në detyrë..... 20525
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 813, datë 24.12.2021	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2021, miratuar për Agjencinë për Dialog dhe Bashkëqeverisje, për financimin e programit të “Këshillimit Kombëtar”..... 20526
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 815, datë 24.12.2021	Për transferimin në pronësi të Bashkisë Gjirokastrë, për njësinë administrative Gjirokastrë, të pasurive 15/179 dhe 15/180, me vendndodhje në zonën kadastrale 8543, dhe të një pjese të pasurisë 8/137, me vendndodhje në zonën kadastrale 8542..... 20531
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 24.12.2021	Për disa ndryshime në vendimin nr. 26, datë 20.1.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit/ rikonstruksionit të objekteve arsimore në bashkitë Kamzë dhe Kavajë dhe caktimin e tyre si njësi zbatuese”, të ndryshuar..... 20537
Vendim i Këshillit të Ministrave nr.859, datë 29.12.2021	Për disa shtesa në vendimin nr.929, datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, të ndryshuar..... 20537

**VENDIM****Nr. 810, datë 24.12.2021****PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN
NR. 717, DATË 23.6.2009, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PAGAT E
PUNONJËSVE MBËSHTETËS TË
INSTITUCIONEVE BUXHETORE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 18/2, të vendimit nr. 717, datë 23.6.2009, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 18/3, me këtë përmbajtje:

“18/3. Paga mujore për punonjësit, që punojnë në pozicionin “prozektor” në Institutin e Mjekësisë Ligjore, të jetë e njëjtë me pagën mujore për të njëjtin pozicion pune në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, e përcaktuar në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e personelit mjekësor dhe punonjësve të personelit teknik të shkencave mjekësore në sistemin e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë.”.

2. Efektet financiare për paga e sigurime shoqërore, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, fillojnë nga momenti i emërimit të punonjësve në pozicionet e punës “prozektor” në strukturën dhe organikën e Institutit të Mjekësisë Ligjore dhe përballohen nga buxheti i miratuar për këtë institucion.

3. Ngarkohet Instituti i Mjekësisë Ligjore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

VENDIM**Nr. 811, datë 24.12.2021****PËR LIRIM NGA DETYRA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Dajna Sorensen, zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë, lirohet nga kjo detyrë. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

VENDIM**Nr. 812, datë 24.12.2021****PËR EMËRIM NË DETYRË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Olta Manjani emërohet zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

**VENDIM****Nr. 813, datë 24.12.2021****PËR NJË SHITESË FONDI NË
BUXHETIN E VITIT 2021, MIRATUAR
PËR AGJENCINË PËR DIALOG DHE
BASHKËQEVERISJE, PËR FINANCIMIN
E PROGRAMIT TË “KËSHILLIMIT
KOMBËTAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 45, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, në llogarinë ekonomike 604 “Transferta korentë të brendshme”, i shtohet fondi prej 40 000 000 (dyzet milionë) lekësh, për financimin e programit të “Këshillimit Kombëtar”.

2. Miratimin e programit të “Këshillimit Kombëtar” si një proces gjithëpërfshirës në kuadër të parimeve të bashkëqeverisjes, për përmbushjen e objektit të mendimdhënies së publikut nëpërmjet mbledhjes së opinionit të qytetarëve mbi politikën, nismat, vendimmarrjen e Këshillit të Ministrave, si dhe mbi çështjet që lidhen me veprimtarinë e institucioneve të administratës shtetërore në drejtim të dhënies së shërbimeve cilësore ndaj publikut.

3. Mbledhja e opinionit të qytetarëve në kuadër të këtij procesi këshillimi kryhet nëpërmjet plotësimit nga ana e tyre të një pyetësoi të hartuar në përputhje me modelin e parashikuar në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë

përbërëse e tij, që është anonim dhe mund të plotësohet nga kryefamiljari dhe/ose anëtarë të familjes në moshë madhore në rrugë digjitale apo edhe në letër.

4. Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje është institucioni përgjegjës për zhvillimin dhe monitorimin e programit në bashkëpunim me INSTAT-in dhe Posta Shqiptare, sh.a.-në, apo me çdo institucion publik tjetër të nevojshëm, sipas marrëveshjes së bashkëpunimit ndërinstitucional që lidhet midis tyre për kryerjen e fazave specifike të procesit në përputhje me kuadrin ligjor institucional të secilit prej këtyre institucioneve.

5. Mbledhja e të dhënave të pyetësorit të këshillimit kombëtar kryhet vetëm për qëllime statistikore, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për statistikën zyrtare dhe legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

6. Rezultatet e përgjigjeve të pyetësorit të programit të “Këshillimit Kombëtar” bëhen publike nëpërmjet publikimit në media dhe në faqen zyrtare të Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje, brenda 4 (katër) javëve nga momenti i përfundimit të afatit për dërgimin e përgjigjeve të pyetësorit.

7. Fondi prej 40 000 000 (dyzet milionë) lekësh, sipas pikës 1, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, i miratuar për vitin 2021.

8. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje, Posta Shqiptare, sh.a., dhe INSTAT-i për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**



www.keshillimikombetar.al



KËSHILLIMI KOMBËTAR

LE TË DËGJOJMË
NJËRI-TJETRIN!

TEMAT: Ekonomia | Punësimi | Bashkimi Europian | Familja | Lufta ndaj krimit

PYETJET

Ky pyetësor është anonim. Pyetësi mund të plotësohet nga kryefamiljari ose çdo pjesëtar i familjes mbi 18 vjeç.

- 1** Ka njerëz që thonë se nënat që rrisin tre ose më shumë fëmijë të mitur duhet të përfitojnë mbrojtje të veçantë sociale nga shteti. Të tjerë thonë se shteti nuk duhet të bëjë diferencime as në këtë rast. Si mendoni ju?

Në Shqipëri ka një numër të madh nënash me disa fëmijë, të cilat për të rritur fëmijët nuk shkojnë në punë ose edhe kur punojnë, janë në kushte më të vështira se të punësuarit e tjerë. Kujdesi për fëmijët e mitur, sidomos kur janë tre a më shumë, është i barabartë me një punë me kohë të plotë.

- ☐ Shteti shqiptar duhet të sigurojë mbrojtje të veçantë sociale për nënat me tre apo më shumë fëmijë të mitur, të punësuar apo jo.
- ☐ Nuk duhet dhënë mbrojtje e diferencuar sociale as për nënat me tre apo më shumë fëmijë të mitur, të punësuar apo jo.
- ☐ Nuk di të gjykoj mbi këtë çështje.

- 2** Ka njerëz që thonë se Shqipëria duhet të ashpërsojë dënimin e autorëve përsëritës në kryerjen e krimeve të rënda kundër personit, duke e dyfishuar dënimin për ta dhe duke hequr të drejtën e gjyqimit të shkurtuar për autorët që kryejnë dhunë në familje dhe krime ndaj fëmijëve. Të tjerë thonë se dënimet në fuqi janë të mjaftueshme për përsëritësit dhe dhunuesit ndaj familjes e fëmijëve. Cili është mendimi juaj?

Kjo masë garanton që autorët përsëritës të krimeve të rënda kundër personit të marrin dënime edhe më të ashpra se sa ato që parashikojnë ligjet në fuqi, ndërkohë që personat që ushtrojnë dhunë në familje dhe krime kundër fëmijëve të mos kenë mundësinë të përfitojnë ulje dënimi prej gjyqimit të shkurtuar.

- ☐ Shqipëria duhet të ashpërsojë dënimet ndaj këtyre autorëve.
- ☐ Nuk kemi nevojë për masa të tilla.
- ☐ Nuk di të gjykoj mbi këtë çështje.

www.keshillimikombetar.al



KËSHILLIMI KOMBËTAR SHQIPTAR

LE TË DËGJOJMË NJËRI-TJETRIN!

- 3** Ka njerëz që thonë se të punësuarit, që denoncojnë metoda të pagave fiktive nga punëdhënësi, duhet të mbrohen nga shteti me dëmshpërblim financiar në rast largimi të padrejtë nga puna kur denoncimi i tyre vërtetohet, ndërsa punëdhënësi në fjalë duhet penalizuar me ashpërsim të masave në fuqi. Të tjerë thonë që masat në fuqi ndaj punëdhënësve që abuzojnë me pagat e punonjësve janë të mjaftueshme. Si mendoni ju?

Informaliteti në tregun e punës lidhet edhe me rastet e punonjësve, që nën presionin e punëdhënësit paguhën më pak se sa figuron në deklarinim zyrtar të pagës së tyre. Punonjësit janë të prirur për të mos e denoncuar këtë abuzim, nga frika e largimit të padrejtë nga puna. Në mënyrë që t'i vihet fre këtij fenomeni, punonjësve denoncues që provojnë se punëdhënësit e tyre përdorin metoda të paligjshme të fiktivitetit në paga, u duhet mbrojtje me masa konkrete, përfshirë edhe dëmshpërblim financiar për pagën e humbur.

- ☐ Shteti shqiptar duhet të sigurojë mbrojtje të veçantë, përfshirë dëmshpërblim financiar për punëmarrësit që denoncojnë punëdhënësit për paga fiktive dhe duhet të ashpërsojë masat për punëdhënësit abuzues.
- ☐ Nuk ka nevojë për këto masa të reja, pasi masat ligjore në fuqi janë të mjaftueshme për të luftuar fenomenin.
- ☐ Nuk di të gjykoj mbi këtë çështje.

- 4** Ka njerëz që thonë se ata që kanë fituar statusin e pensionistit, por që vazhdojnë ende të punojnë, nuk duhet të paguajnë kontributet shoqërore. Të tjerë mendojnë që nuk duhet bërë një diferencim i tillë. Si mendoni ju?

Pensionistët e kanë dhënë kontributin e tyre financiar gjatë gjithë viteve të punës deri në momentin e daljes në pension. Pas këtij momenti, nëse ata zgjedhin të vazhdojnë të punojnë, nuk kanë përse të vazhdojnë të paguajnë sigurimet shoqërore, përderisa detyrimin e tyre e kanë shlyer më parë.

- ☐ Pensionistët që punojnë nuk duhet të paguajnë kontribute shoqërore.
- ☐ Nuk ka nevojë për këtë diferencim për pensionistët që punojnë.
- ☐ Nuk di të gjykoj mbi këtë çështje.

- 5** Ka njerëz që thonë se emigrantëve shqiptarë që duan të depozitojnë në Shqipëri kursimet e tyre duhet t'u jepet amnisti e plotë. Të tjerë thonë se depozitimet në vendin tonë të kursimeve të punës në emigracion nuk duhen inkurajuar përmes amnistisë. Si mendoni ju?

Shumë emigrantë, ndër vite, kanë kursyer para cash të cilat nuk i sjellin dot në Shqipëri përmes sistemit bankar. Nëse ata zgjedhin t'i sjellin këto kursime në vendin tonë përmes bankave, do të jenë plotësisht të amnistuar për sa kohë paratë e tyre nuk burojnë nga aktivitete kriminale.

- ☐ Emigrantët që duan të depozitojnë kursimet e tyre në Shqipëri duhet të përfitojnë amnisti të plotë.
- ☐ Ne nuk duhet ta inkurajojmë me amnisti të plotë depozitimet e kursimeve të emigrantëve në Shqipëri.
- ☐ Nuk di të gjykoj mbi këtë çështje.

- 6** Ka njerëz që thonë se Shqipëria duhet të lejojë kultivimin, përpunimin dhe eksportimin e kontrolluar nga shteti të kanabisit për qëllime mjekësore, pa e legalizuar për arsye përdorimi vetjak. Të tjerë thonë që kanabisi nuk duhet të lejohet as për qëllime mjekësore. Si mendoni ju?

Kanabisi mjekësor, i cili është i ndryshëm nga kanabisi për përdorim vetjak, provohet gjerësisht nga shkenca se ka efekte kurative. Megjithatë, siç rezulton nga eksperiencia e vendeve të ndryshme të rajonit apo botës, shfrytëzimi i kontrolluar i kanabisit nga shteti ka impakt shumë pozitiv jo vetëm në shëndetësi, por edhe në rritjen ekonomike dhe në luftën kundër shfrytëzimit të paligjshëm të kësaj bime.

- ☐ Shqipëria duhet të lejojë kultivimin, përpunimin dhe eksportimin e kontrolluar nga shteti të kanabisit mjekësor.
- ☐ Nuk kemi nevojë për këtë nismë.
- ☐ Nuk di të gjykoj mbi këtë çështje.



KËSHILLIMI KOMBËTAR SHQIPTAR

LE TË DËGJOJMË NJËRI-TJETRIN!

- 7** Ka njerëz që thonë se ashtu si vendet e tjera të Europës, Shqipëria duhet të vendosë detyrimin që qytetarët të paraqesin certifikatën e vaksinimit në të gjitha hapësirat publike të mbyllura dhe në tubimet e mëdha. Të tjerë thonë se kjo praktikë nuk duhet të jetë e detyrueshme pasi kufizon liritë dhe të drejtat e njeriut. Si mendoni ju?

Në shumë vende të Europës certifikata e vaksinimit është bërë kusht për të hyrë në dyqane, lokale, mjedise pune e vende të tjera të mbyllura publike, si masë mbrojtëse kundër Covid-19.

- ☐ Shqipëria duhet të përdorë certifikatat e vaksinimit anti-Covid19 për të penguar përhapjen e virusit.
- ☐ Shqipëria nuk duhet të përdorë certifikatat e vaksinimit anti-Covid19.
- ☐ Nuk di të gjykoj mbi këtë çështje.

- 8** Ka njerëz që thonë se qeveria duhet të ashpërsojë gjokat dhe masat kundër evazionit fiskal të shoqërive të biznesit të madh. Të tjerë thonë se rregullat në fuqi janë të mjaftueshme nëse zbatohen si duhet. Si mendoni ju?

Sa më shumë të shmanget biznesi i madh nga detyrimet për të paguar taksa, aq më shumë pengohet rritja e investimeve të shtetit në infrastrukturë e shërbime publike, si edhe rritja e pagave e pensione. Duke ashpërsuar masat ndaj biznesit të madh, që kryen evazion fiskal, sigurohem që ata që fitojnë më shumë e kanë më të vështirë t'u shmangen detyrimeve ndaj shtetit e shoqërisë.

- ☐ Biznesi i madh duhet të ndëshkohet penalisht me dënime më të ashpra për evazion fiskal.
- ☐ Legjislacioni aktual është mjaftueshëm i ashpër për të luftuar fenomenin.
- ☐ Nuk di të gjykoj mbi këtë çështje.

- 9** Ka njerëz që thonë se qeveria duhet të tregohet më e ashpër jo vetëm me subjektet, po edhe me individët që ndotin hapësirat publike. Të tjerë thonë se rregullat aktuale janë të mjaftueshme. Si mendoni ju?

Shpeshherë individë që ndotin hapësirat publike dhe mjedisin ndëshkohen pak ose aspak nga autoritetet. Shumë praktika të vendeve të tjera tregojnë se ashpërsimi i masave, jo vetëm mbi subjektet ndotëse po gjithashtu edhe mbi individët, që hedhin mbeturinat lart e poshtë në mjediset publike, ul ndjeshëm ndotjen e mjedisit.

- ☐ Qeveria duhet të jetë më e ashpër dhe të penalizojë individët/subjektet që ndotin mjedisin.
- ☐ Nuk duhet ashpërsim i masave ekzistuese ndaj individëve/subjekteve ndotës të hapësirave publike.
- ☐ Nuk di të gjykoj mbi këtë çështje.

- 10** Ka njerëz që thonë se gjyqtarët dhe prokurorët, që nuk kanë kaluar ende Vetingun, duhet të pezullohen automatikisht nga sistemi i drejtësisë nëse vendimarrjet e tyre janë haptazi në kundërshtim me ligjin. Të tjerë thonë se pezullimi dhe përjashtimi nga sistemi duhet të kryhet sipas procedurave në fuqi. Si mendoni ju?

Pavarësisht se vitet e fundit janë bërë ndryshime legjislative për të luftuar fenomenin e njohur si KÇK, një pjesë e gjyqtarëve dhe prokurorëve në pritje të Vetingut vazhdojnë të abuzojnë me pushtetin e drejtësisë. Aktualisht, nuk është i mundur pezullimi automatik i tyre nga institucionet kompetente të drejtësisë në rastet kur konstatohen vendimeve haptazi të paligjshme, sepse për të realizuar pezullimin institucionet duhet të kryejnë hetime të thelluara që kërkojnë një kohë të gjatë.

- ☐ Gjyqtarët dhe prokurorët që abuzojnë me detyrën e tyre duhet të pezullohen automatikisht nëse vendimarrjet e tyre janë haptazi në kundërshtim me ligjin.
- ☐ Gjyqtarët dhe prokurorët që abuzojnë me detyrën e tyre nuk duhet të pezullohen pa një hetim të thelluar sado kohë që ky hetim të kërkojë.
- ☐ Nuk di të gjykoj mbi këtë çështje.



KËSHILLIMI KOMBËTAR SHQIPTAR

LE TË DËGJOJMË NJËRI-TJETRIN!

- 11** Anëtarësimi i Shqipërisë në Bashkimin European është i lidhur me anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut. Ka njerëz që thonë se aplikimi i Shqipërisë për anëtarësim në BE duhet të ndahet nga ai i Maqedonisë së Veriut, që vendi ynë të vlerësohet për meritat e veta. Të tjerë thonë që duhet të vazhdojmë të presim Maqedoninë e Veriut. Si mendoni ju?

Një shtet anëtar i BE-së ka çështje të pazgjidhura dypalëshe me Maqedoninë e Veriut, prandaj bllokun me veto në Këshillin European fillimin e negociatave për anëtarësimin e saj në BE, duke bllokuar edhe Shqipërinë, megjëse aplikimet për të dyja vendet trajtohen si një dosje e vetme në tryezën e Këshillit European. Në rast se edhe në përfundim të 6 muajit të parë të vitit 2022 vetoja mbi Maqedoninë së Veriut nuk hiqet, Shqipëria duhet të kërkojë ndarjen e dosjes dhe trajtimin më vete nga Këshilli European

- ☐ Ne duhet të kërkojmë që Shqipëria të vlerësohet ndarazi nga Maqedonia e Veriut.
- ☐ Ne duhet të vazhdojmë të presim heqjen e vetos mbi Maqedoninë e Veriut.
- ☐ Nuk di të gjykoj mbi këtë çështje.

- 12** Ka njerëz që besojnë se krijimi i nismës "Ballkani i Hapur" midis Shqipërisë dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor është në interes të Shqipërisë. Të tjerë thonë se kjo nismë nuk i sjell përfitime Shqipërisë. Si mendoni ju?

Aktualisht, ekzistojnë shumë barriera lidhur me lëvizjen e njerëzve, mallrave, shërbimeve dhe kapitalit në vendet e Ballkanit Perëndimor. Krijimi i Ballkanit të Hapur do të rrëzonte barrierat e lëvizjes së lirë sipas modelit european, duke i sjellë Shqipërisë dhe shqiptarëve avantazhe të reja ekonomike e sociale, si edhe do të promovonte më tej paqen në rajon.

- ☐ Besoj se "Ballkani i Hapur" është një nismë e dobishme për Shqipërinë dhe paqen në rajon.
- ☐ Besoj se "Ballkani i Hapur" nuk është një nismë e dobishme për Shqipërinë dhe paqen në rajon.
- ☐ Nuk di të gjykoj mbi këtë çështje.



KËSHILLIMI KOMBËTAR

LE TË DËGJOJMË NJËRI-TJETRIN!

SHËNIM

Të dhënat e plotësuara në këtë pyetësor do trajtohen në respektim të ligjit **nr.9887/2008** "Për mbrojtjen e të dhënave personale". Informacioni i mbledhur nga ky pyetësor do të përdoret vetëm për qëllime statistikore, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për statistikën zyrtare dhe do të kryhet në mënyrë anonime. Përpunimi i të dhënave të deklaruara, në kundërshtim me qëllimin e sipercituar përbën kundërvajtje administrative sipas nenit **39 të ligjit nr. 9887/2008** "Për mbrojtjen e të dhënave personale".



VENDIM

Nr. 815, datë 24.12.2021

**PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË
BASHKISË GJIROKASTËR, PËR NJËSINË
ADMINISTRATIVE GJIROKASTËR, TË
PASURIVE 15/179 DHE 15/180, ME
VENDNDODHJE NË ZONËN
KADASTRALE 8543, DHE TË NJË PJESE
TË PASURISË 8/137, ME VENDNDODHJE
NË ZONËN KADASTRALE 8542**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të Bashkisë Gjirokastrë, për Njësine Administrative Gjirokastrë, të pasurive 15/179 dhe 15/180, me vendndodhje në zonën kadastrale 8543, dhe të një pjese të pasurisë 8/137, me vendndodhje në zonën kadastrale 8542, sipas formularëve dhe planeve të rëlevimit, bashkëlidhur këtij vendimi, me qëllim për t’u përdorur në fushën e strehimit social, infrastrukturës vendore dhe kulturës.

2. Bashkisë Gjirokastrë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit ose t’i tjetërsojë pasuritë e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Bashkia Gjirokastrë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

3.FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETERORE
(Te tipit te pronave qe inventarizohen si klasa te veçanta)

Aprovat: Flamur Golemi (Kryetar Bashkie)

Njësia Administrative : Gjirokastrë


Fusha e përdorimit të Pronës: Kulturë - Histori - Sport

Nr. Rend.	A		B			C				
	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te vecanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
31	8542 1 - 7	8/137	Truall + Ndërtesë	Qendra Kulturore e Fëmijëve Pazar Bashkia Gjirokastrë	740	382	Kulturë	Bashkia Gjirokastrë	Bashkia Gjirokastrë	Pasuria 8/137 eshte 3404,17 m2 dhe ajo qe do t'i kaloje Bashkise eshte 740 m2,nga e cila 382 m2 objekt dhe 358 m2 truall.



3.FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUATSHME SHETERORE

(Te tipit te pronave qe inventarizohen si klasa te vecanta)

Njësia Administrative : Gjirokastër Fusha e përdorimit të Pronës: Troje											
Aprovoi:  Flamur Golemi (Kryetar Bashkie) (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, fletë, firma, vula)											
A				B			C				
Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartës	Nr. Pasurisë	Lloji i Pronës	Emri i Pronës Adresa	Sip. Totale e Pronës (m ²)	Nga Sip. Totale: Sa Ndërtëse (m ²)	Funksioni për të cilin përdoret Prona	Institucioni / Enti me përgjegjësi administrative	Institucioni / Enti përdorues Statusi juridik i përdorimit	Te dhëna të tjera (Shënime të veçanta)	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	
761/1	8543 GJ-L-9	15/179	Truall	Lagja "Zinxhira" Bashkia Gjirokastër	1047		Infrastrukturë Vendore	Bashkia Gjirokastër	Bashkia Gjirokastër	Pjesë e 15/50	



3.FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETERORE

(Te tipit te pronave qe inventarizohen si klasa te vecanta)

Njësia Administrative : Gjirrokastër		Aprovoi:  Flamur Golemi (Kryetar Bashkie)		Emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel./firma, vendlindja						
Fusha e përdorimit të Pronës: Troje										
A		B								
Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartës	Nr. Pasurisë	Lloji i Pronës	Emri i Pronës Adresa	Sip. Totale e Pronës (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndërtese (m2)	Funksioni për të cilin përdoret Prona	Institucioni / Enti me përgjegjësi administrative	Institucioni / Enti përdorues Statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (Shënime të vecanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
761/2	8543 GJ-L-9	15/180	Truall	Lagja "Zinxhira" Bashkia Gjirrokastër	1328		Infrastrukturë Vendore	Bashkia Gjirrokastër	Bashkia Gjirrokastër	Pjesë e 15/50



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE						
PRONARI: Shtet		DATE: 30/09/2021		QELLIMI: Kalim ne pronesi		
VENDNDODHJA: Qendra Kulturore e Femijeve (Q.K.F) Gjirokaster						
BASHKIA: Gjirokaster		DVASHK: Gjirokaster		ZONA KADASTRALE: 8542		
TE DHENAT E PASURISE		NUMRI PASURISE: 8/137		INDEX HARTE: GJ- I-7		
LLOJI PASURISE: Truall + Nd.		SIPERFAQE e PASURISE: 740 m2		SIP. GJURMES NDERTIMIT: 382 m2		
511821.0576		512015.3284		4437949.0970		
KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE						
511821.0576		SH 1:1000		512015.3284		
4437820.1546				4437817.2784		
Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1	Veri	Tr + Ba	Truall	8/205-8/140-(8/1337 Proj. Parking)		
2	Jug	Truall	Truall	8/137 Sip e prekur nga Parking		
3	Lindje	Rruge	Truall	8/137 Sip e prekur nga Parking		
4	Perendim	Truall	Tru	8/258		
REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT EMRI: Kaliope Buka Rebi LICENCA: NR. 0565 DATE 05/02/2008 KOMPANIA: Bashkia Gjirokaster NIPT: _____ NENSHKRIMI/VULA: _____			TEKNOLOGJIA E MATJEVE: T - Terren , Z - Zyre Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; PERCAKTIMI KUFIRIT: HK - Harta Kadastrale Kode per percaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale; SHENIME TE VECANTA: Prona Nr.8/137 ka nje sip. totale prej 3404.17 m2 nga te cilat pas zbatimit te projektit per parkimin nentokesor dhe sistemimit te teritorit rreth saj ngelen te lira per rregjistrim 740 m2 (nga te cilat objekt = 382 m2 dhe Truall = 358 m2) Truall = 358 m2 Objekt = 382 m2 PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET EMRI: _____ NENSHKRIMI: _____			
KONFIRMOI PER BASHKINE GJIROKASTER KRYETAR: Flamur Golemi NENSHKRIMI / VULA: _____						
Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale						



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE					
PRONARI _SHTET		DATE 05/07/2021		QELLIMI : KALIM NE PRONESI	
VENDNDODHJA BASHKIA GJIROKASTER DVASHK GJIROKASTER ZONA KADASTRALE_8543 NUMRI PASURISE 15 / 179 INDEX HARTE: GJ - L - 9 TE DHENAT E PASURISE LLOJI PASURISE: Truall SIP.PASURISE=1047 m2 SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT=_ NUMRI KATEVE : _ NUMRI PEMEVE_0					
512522.3731 4437135.9848		KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE		512619.7317 4437135.9848	
512522.3731 4437071.5820		SH 1:500		512619.4317 4437071.5820	
Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT
1	Veri	Shkembor	Skarpate	16/76	
2	Jug	-	Sip. e lire	16/178	
3	Lindje	Truall	Truall	15/180	
4	Perendim	-	Sip. e lire	16/178	
REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT EMRI: Kaliopi Buka Rebi LICENCA: NR. 0565 DATE 05/02/2006 KOMPANIA: Bashkia Gjirokastrer NIPT: KALIOPIBUKA NENSHKRIMI/VULA: KALIOPIBUKA REALIZOI PER ASHK SPECIALISTI _____ DVASHK _____ NENSHKRIMI _____			TEKNOLOGJIA E MATJEVE: Z - Zyre T - Terren Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; PERCAKTIMI KUFIRIT: HK-Harta Kadastrale Kode per percaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale; SHENIME TE VECANTA:		
KONFIRMOI PER BASHKINE GJIROKASTER KRYETAR : Flamur Golemi NENSHKRIMI / VULA _____			PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET EMRI _____ NENSHKRIMI _____		
Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale					



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI _SHTET

DATE 05/07/2021

QELLIMI : KALIM NE PRONESI

VENDNDODHJA

DVASHK GJIROKASTER

ZONA KADASTRALE _8543

NUMRI PASURISE 15/180

INDEX HARTE: Gj - L - 9

TE DHENAT E PASURISE

LLOJI PASURISE: Tual

SIP.PASURISE=1328 m2

SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT= _ m2

NUMRI KATEVE : _

NUMRI PEMEVE_0

512524.4111
4437138.9992

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

512621.5098
4437138.9992

SH 1:500

512524.4111
4437074.6210

512621.5098
4437074.6210

Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1	Veri	Shkembor	Skarpate	16/76		
2	Jug	-	Sip e Lire	16/178		
3	Lindje	Truall	Truall	15/38 , 15/37		
4	Perendim	Trruall	Trruall	15/179		

REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT

EMRI: Kaliopi Buka Rebi

LICENCA: NR. 0565 DATE 05/02/2005

KOMPANIA: Bashkia Gjirokastrer

NIPT: 12056

NENSHKRIMI/VULA _____

REALIZOI PER ASHK

SPECIALISTI _____

DVASHK _____

NENSHKRIMI _____

KONFIRMOI PER BASHKINE GJIROKASTER

KRYETAR : Flamur Golemi

NENSHKRIMI / VULA _____

TEKNOLOGJIA E MATJEVE: T - Terren , Z - Zyre

Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash;

PERCAKTIMI KUFIRIT: HK-Harta Kadastrale

Kode per percaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale;

SHENIME TE VECANTA:

PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET

EMRI _____

NENSHKRIMI _____

**VENDIM****Nr. 817, datë 24.12.2021****PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 26, DATË 20.1.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT/RIKONSTRUKSIONIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE NË BASHKITË KAMZË DHE KAVAJË DHE ÇAKTIMIN E TYRE SI NJËSI ZBATUESE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” e “iii”, 16, e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 26, datë 20.1.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 2, shifra “... 914 561 348 (nëntëqind e katërmëdhjetë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e treqind e dyzet e tetë) lekë pa TVSH ...” zëvendësohet me “... 1 114 561 348 (një miliard e njëqind e katërmëdhjetë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e treqind e dyzet e tetë) lekë pa TVSH ...”.

b) Në shkronjën “a”, të pikës 2, shifra “... 445 562 231 (katërqind e dyzet e pesë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e dyqind e tridhjetë e një) lekë pa TVSH ...” zëvendësohet me “... 645 562 231 (gjashtëqind e dyzet e pesë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e dyqind e tridhjetë e një) lekë pa TVSH ...”.

2. Efektet financiare, sipas pikës 1, të këtij vendimi, të përballohen nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2021.

3. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e

Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM**Nr.859, datë 29.12.2021****PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.929, DATË 17.11.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN DHE PËRDORIMIN E FONDIT TË VEÇANTË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr.10405, datë 23.4.2011, “Për kompetencat për përcaktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, dhe të neneve 12 e 14, të ligjit nr.137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 9, të vendimit nr.929, datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

a) Pas fjalëve “... Policisë së Shtetit, ...” shtohen fjalët “... Gardës së Republikës së Shqipërisë, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, Gjykatës Kushtetuese ...”;

b) Në fund të pikës 9 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Efektet financiare për shpërblimin e punonjësve të Gardës së Republikës së Shqipërisë, në vlerën 80 000 000 (tetëdhjetë milionë) lekë, përballohen nga fondi rezervë i buxhetit të vitit 2021.”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe institucionet e përmendura në pikën 1, të këtij vendimi, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 64 lekë